



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 426/12 prot.

Datë 06.03.2024

V E N D I M

Nr. 240/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 06.03.2024, mori në shqyrtim çështjen me,

Objekt: Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 228/2024/, datë 29.02.2024 për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-95574-02-15-2024, me objekt: “Shërbim printimi dhe mirëmbajtje e pajisjeve informatike”, me fond limit 1,770,833.lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 27.02.2024, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Patos.

Ankimues: Operatori ekonomik “Erisoni Company” SHPK me NIPT K92006501A dhe adresë: Lagjia 6, Rruga “Shoqëria Bashkimi”, Pallati Clas, kati i parë, Durrës.

Operatori ekonomik “InfoSoft Office” SHPK me NIPT J62426002Q dhe adresë: Autostrada Tiranë-Durrës, km.8, Kashar, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Patos.
Adresa: Lagjia “Naftëtari”, Rruga “Unaza, Patos

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr.766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik”

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datë 29.02.2024, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 228/2024, ku vendosi:
[...]

Vendosi

- 1. Të mbyllë çështjen për ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Erisony Comapy” SHPK, për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-95574-02-15-2024, me objekt: “Shërbim printimi dhe mirëmbajtje e pajisjeve informatike”, me fond limit 1,770,833.lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 27.02.2024, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Patos.*
- 2. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “InfoSoft Office” SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit.*
- 3. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “InfoSoft Office” SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit.*
- 4. Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet përkatëse në përputhje me arsyetimet dhe konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe të publikojë të gjitha ndryshimet në Sistemin Elektronik të Prokurimeve.*
- 5. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.*
- 6. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Erisony Comapy” SHPK dhe operatori ekonomik “InfoSoft Office” SHPK.*
- 7. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
- 8. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën nr. 543/13 prot., datë 05.03.2024, (dërguar në adresën elektronike të KPP) protokolluar me tonën nr.426/9 prot., datë 06.03.2024, autoriteti kontraktor, njofton se ka zbatuar vendimin 228/2024 , datë 29.02.2024 të Komisionit të Prokurimit Publik për procedurën e “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-95574-02-15-2024, me objekt: “Shërbim printimi dhe mirëmbajtje e pajisjeve informatike”, me fond limit 1,770,833.lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 27.02.2024, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Patos.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton

II.1. Me shkresën nr. 543/13 prot., datë 05.03.2024, (dërguar në adresën elektronike të KPP) protokolluar me tonën nr.426/9 prot., datë 06.03.2024, autoriteti kontraktor, njofton se ka zbatuar vendimin 228/2024 , datë 29.02.2024 të Komisionit të Prokurimit Publik për procedurën e “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-95574-02-15-2024, me objekt: “Shërbim printimi dhe mirëmbajtje e pajisjeve informatike”, me fond limit 1,770,833.lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 27.02.2024, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Patos.

II.2.Referuar shkresës së mësipërme, të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe verifikimeve të kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike konstatohet, se autoriteti kontraktor ka publikuar shtojcën për modifikimin e dokumenteve të tenderit të procedurës së mësipërme të prokurimit, e cila është në përputhje me vendimin nr.228/2024, datë 29.02.2024 të këtij Komisioni.

II.3. Sa më sipër, Komisioni konstaton se autoriteti kontraktor ka zbatuar vendimin nr. 228/2024, datë 29.02.2024, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi pasi ka publikuar në sistemin e prokurimit elektronik (SPE) shtojcën me ndryshimet në dokumentat e tenderit në përputhje me konstatimet e vendimit 228/2024, datë 29.02.2024 të Komisionit të Prokurimit Publik.

Për sa më sipër, në mbështetje të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik nr.766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-95574-02-15-2024, me objekt: “Shërbim printimi dhe mirëmbajtje e pajisjeve informatike”, me fond limit 1,770,833.lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 27.02.2024, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Patos.
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Nënkryetar
Fiorent Zguro

